




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT VLORE

Nr.Regj.Themeltar 383/190/52

Nr. i Vendimit 174



V E N D I M

“Në Emër të Republikës”

Gjykata e Apelit Vlorë e përbërë nga:

Klodiana Gjyzari- Kryesuese
Hysen Saliko-Anëtar
Skënder Damini-Anëtar

Asistuar nga sekretarja e seancës gjyqësore [REDACTED], sot më 24.10.2019, në Vlorë, në seancë gjyqësore publike, mori në shqyrtim çështjen civile nr.383/190/52, që i përket:

KËRKUESE: [REDACTED], në mungesë.

PERSONA TË TRETË: Shoqëria “Strean Oil&Gas” Ltd, në mungesë.
Shoqëria “Albpetrol” sh.a. në mungesë.
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në mungesë.

OBJEKTI: Rivendosja në afat për të ngritur padinë me objekt konstatimin e diskriminimit nga punëdhënësi dhe njohjen e dëmshpërblimit përkatës.

BAZA LIGJORE: Neni 145, 152 të K.Pr.Civile

Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 264 datë 19.04.2016, ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj.
2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuesses [REDACTED]

Kundër vendimit ka paraqitur ankim të shkurtër kërkuessja [REDACTED] në të cilin nuk parashtron shkaqet e ankimit

GJYKATA E APELIT VLORE:

Në seancë gjyqësore, të zhvilluar në mungesë të palëve, pasi dëgjoi relatoren Klodiana Gjyzari, konstatoi se ankimi është me të meta

V Ë R E N

Se, ankimi i ankueses Ismiha Gaba është i papranueshëm për shkak të mungesës së formës së parashikuar në ligj. Kjo e metë nuk është plotësuar nga ankuesja brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, për pasojë Gjykata e Apelit vendosi mospranimi I ankimit.

Rezulton që kundër vendimit nr. 264 datë 19.04.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ankuesja [REDAKTUAR] ka paraqitur dëshirën për ta kundërshtuar këtë vendim, me anë të një shkrese nga përmbajtja e së cilës rezulton që “meqënëse vendimi nuk është zbardhur akoma paraqes këtë ankim për hapje afati”.

Pas kësaj shkrese të kërkuases [REDAKTUAR] Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë ka dërguar dosjen në Gjykatën e Apelit. Nga kjo Gjykatë i është kthyer dosja Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me qëllim që të kryhej procedura e komunikimit të vendimit dhe të plotësimit të shkaqeve të ankimit nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë ka njoftuar kërkuesen për të plotësuar të metat e ankimit bazuar në nenin 455/b të K.Pr.Civile dhe më pas ka ridërguar dosjen për gjykim në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit konstaton se kërkuësja [REDAKTUAR] nuk ka plotësuar të metat e ankimit megjithëse vendimi është dhënë në muajin prill 2016.

Gjykata e Apelit çmon se kërkuësja ka dijeni sipas nenit 455 gërma “b” të Kodit të Procedurës Civile sipas të cilit: *“Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet e mësipërme, si dhe ato të neneve 453 dhe 454 të këtij Kodi, gjykata njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve, në të kundërt ankimi kthehet.”* për të plotësuar të metat e ankimit dhe nuk ka përmbushur këtë detyrim ligjor.

Gjykata e Apelit cmon se bazuar në nenin 450 paragrafi i dytë, në lidhje me gërmën “b të paragrafit të parë të Kodit të Procedurës Civile do të vendoset mospranimi i ankimit të ankueses Ismiha Gaba.

PËR KËTO ARSYE

Gjykatës së Apelit Vlorë bazuar në nenin 450 paragrafi i dytë të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Mospranimin e ankimit

Vlorë, më 24.10.2019

ANËTAR
HYSEN SALIKO

ANËTAR
SKËNDER DAMINI

KRYESUES
KLODIANA GJYZARI

